| | | detajuar te elementeve te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.<br>4.Kur aplikimi paraqitet nga investori propozues I projektit, kopje te kerkeses shoqeruar me plan biznesi te investimit si dhe informacionin e kerkuar nga legjislacioni ne fuqi.<br>5.Per subjektet qe kane periftuar statusin strategjik procedure e asistuar/vecante, kopje te kerkeses me shkrim se bashku me dokumentacionin perkates te kerkuar nga ligji ne fuqi.<br>6. Per subjektet qe kane periftuar statusin strategjik procedure e asistuar/vecante, kopje vleresimi paraprak te potencialit strategjik pergatitur nga AIDA, kopje te Vleresimit Teknik, Financiar dhe ligjor nga dosjet | | s ka sherbyer si nje hapesire per publikimin e vendimeve te Komitetit te Investimeve Strategjike, formati i te cilave permbledh te gjitha te dhenat e nevojshme mbi nje projekt te caktuar, te miratuar ose jo.<br>AIDA cdo vit publikon Raportin Vjetor ku nje ze te rendesishem ze kapitulli i investimeve strategjike. Ne webin e AIDA ne link https://aida.gov.al/aida/raport-vjetor/ gjeni Raportet e viteve te kaluara ku perfshihet edhe pjesa e investimeve strategjike. Nderkohe bashkelidhur gjeni Raportin Vjetor te vitit 2023, ku ne fund gjendet Regjistri.<br>Per nje informacion me te perditesuar deri ne diten e kthimit te kesaj pergjigje, gjeni tabelen bashkelidhur.<br><br>2. AIDA cdo vit publikon Raportin Vjetor ku nje ze te rendesishem ze kapitulli i investimeve strategjike. Ne webin e AIDA ne link https://aida.gov.al/aida/raport-vjetor/ gjeni Raportet e viteve te kaluara ku perfshihet edhe pjesa e investimeve strategjike. Nderkohe bashkelidhur gjeni Raportin Vjetor te vitit 2023.<br>Lutem te kihet parasysh qe referuar legjislacionit ne fuqi:<br>• Cdo miratim nga KIS ne asnje rast nuk do te konsiderohet investim, qofte sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij nderkombetar, ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, duke qene se miraton ne parim realizimin e nje projekti investimi, materializimi i te cilit do të bazohet ne permbushjen e detyrimeve dhe kushteve qe parashikojne legjislacionet sektoriale në fuqi.<br>• Per cdo projekt investimi per te cilat me vendim KIS eshte miratuar nje nga masat | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nga GO dhe kopje te vleresimit paraprak te potencialit strategjik nga KIS.<br>7.Per subjektet qe kane perfituar statusin strategjik procedure e asistuar/vecante, listoni masat mbeshtetese/perfitimet me infrastrukture ndihmese dhe perllogaritje e kostos se tyre per shtetin shqiptar.<br>8.Per subjektet qe kane perfituar statusin strategjik procedure e asistuar/vecante, madhesia, vlera dhe natyra e pasurive te paluajtshme shteterore te vena ne dispozicion.<br>9.Per subjektet qe kane perfituar statusin strategjik procedure e asistuar/vecante, madhesia, vlera dhe natyra e shpronesimeve te pasurive te paluajtshme, prone | | mbeshtetese qe parashikon legjislacioni ne fuqi, ekzekutimi i mases mbeshtetese realizohet vetem me vendim te Keshillit te Ministrave dhe nje kontrate te lidhur me autoritetin kompetent, sipas legjislacionit ne fuqi. Ne kete rast kontrata e lidhur i nenshtrohet monitorimit nga autoriteti kompetent sipas kushteve te miratuara ne VKM dhe dakordesuara mes paleve ne kontrate.<br><br>3. I vetmi rast qe AIDA ka trajtuar si nje projekt i propozuar nga Ministrite e Linjes eshte [redacted]<br>Propozimi per kete projekt ka ardhur nga [redacted], pas disa komunikimesh zyrtare ndermjet dy institucioneve e vleresuar sipas kritereve respektive kualifikues.<br>[redacted] me subjekt propozues Bashkia Tiranë", ka vendosur:<br>1. Miratimin e Statusit "Projekt me Potencial Strategjik" për projektin e investimit "[redacted].<br>2. Statusi "Projekt me potencial strategjik" i jepet projektit të investimit "[redacted], për një periudhë 1 (një) vjeçare. Brenda kësaj periudhe, Bashkia Tiranë duhet të aplikojë për përfitimin e statusit përfundimtar 'Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë'. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | private.<br>10.Per subjektet qe kane periftuar statusin strategjik procedure e asistuar/vecante, madhesia, vlera dhe natyra e te drejtave te perdorimit te brigjeve.<br>11. Sipas VKM 1030/2015 “Ministria pergjegjese per ekonomine inventarizon pronat e perfshira ne FPPMIS…..” Kopje te listes se inventarizuar dhe te publikuar te pronave te perfshira ne FPPMIS. Linku e publikimit te pronave<br>12.Sipas VKM 1030/2015 [redacted]<br>kerkohet:<br>a. Kopje te | | Brenda ketij afati, [redacted] paraqiti prane AIDA-s kerkesen per aplikim per marrjen e statusit Investim/Investitor Strategjik me Procedure te Veçante per krijimin dhe funksionimin e [redacted].<br>KIS me vendim Nr. 1/8 date 15 / 07 / 2021 miratoi statusin investim/investitor strategjik, procedure e vecante per projektin [redacted] me qellim shpalljen e [redacted], ne zbatim të nenin 14/1 të VKM Nr. 646/2015 paraqiti pranë [redacted].<br>Referuar ne sa me siper, [redacted] aplikoi per status strategjik sipas legjislacionit ne fuqi dhe iu nenshtrua parashikimeve te VKM Nr. 1026 date 16.12.2015.<br>Per te eazuruar cdo shqetesim tuajin lidhur me proceduren e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo qe ju e keni te mundur te vini prane zyrave të AIDA, per te konsultuar te gjithe dosjen aplikuese ashtu si dhe per te marre te gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion te dorezuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit.<br><br>4 dhe 5 Ne baze dhe zbatim te Ligj 55/2015 i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikohet se subjekti aplikues, pervec te tjerash, dorezon tek AIDA | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumentacionit sic ka parashikuar pika 9 e VKM 1030/2015<br>b. Kopje te propozimit te KIS ku te tregohen forma, niveli dhe menyra e pjesemarrjes shteterore ne investim (pika 19 VKM 1030/2015)<br>c. Kopje te relacionit shoqerues (pika 19 VKM 1030/2015) ne te cilen trajtohen ne menyre te detajuar<br>i. interesi publik dhe jepen arsyet për të cilat konsiderohet e nevojshme pjesëmarrja shtetërore në investim;<br>ii. analiza ekonomike e investimit strategjik dhe e pjesëmarrjes shtetërore;<br>iii. vlerësimi i avantazheve dhe rreziqeve të pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik; | | "*..autorizimin mbi dakordësine e investitorit per publikimin e detajeve të investimit te propozuar, perveç te dhenave qe konsiderohen prej tij si konfidenciale, te cilat nuk mund te bëhen publike apo t'u shfaqen personave te trete*".<br>Kjo dispozite e vecante zberthehet me gjere ne VKM Nr. 1026, date 16.12.2015 "Per vleresimin e dokumentacionit", ku ne Kreun I, pika 4/gj parashikohet shprehimisht se "*Dokumetacioni qe dorezohet duhet te perfshije detyrimisht pranimin e shprehur te investitorit per publikimin e detajeve te pergjithshme te investimit të propozuar, perveç te dhenave qe konsiderohen prej tij si konfidenciale, te cilat nuk mund te behen publike apo t'u shfaqen personave te trete, te percaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar*".<br>Ne dosjet e administruara prane AIDA perfshihen deklaratat e subjekteve aplikuese mbi te dhenat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Ne te tilla kushte, ne pamundesi per te cenuar marreveshjen me subjektin aplikues, por per te ezauruar çdo shqetesim tuajin, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo qe ju e keni te mundur te vini prane zyrave te AIDA, per te konsultuar te gjithe dosjen aplikuese, ashtu si dhe per te marre te gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion te dorezuar.<br><br>6. Ne Kreun II, pika 4 te VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 parashkikhet se "Vlerësimi i potencialit të projektit, nga agjencia, kryhet nëpërmjet grupeve operacionale, të posaçme për çdo projekt, të përbërë nga ekspertë të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | iv. niveli i pjesëmarrjes shtetërore në raport me vlerën totale të investimit;<br>v. shkalla e ndarjes së riskut operacional midis shtetit dhe investitorit strategjik;<br>vi. ndikimet mbi tregun e lirë dhe konkurrencën që sjell pjesëmarrja e shtetit në investim;<br>vii. projekti i marrëveshjes që do të nënshkruhet ndërmjet investitorit dhe shtetit shqiptar, të përfaqësuar nga Agjencia në lidhje me kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve në realizimin e pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik.<br>13. [redacted], vendosja ne dispozicion e pasurive shtetore bazohet ne nenin 27 | | ministrive të linjës, të fushave në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik".<br>Ne reference te VKM te lartpermenduar, AIDA kur arrin ne perfundimin se projekti paraqet potencial strategjik ka detyrimin te informoje Komitetin e Investimeve Strategjike ( KIS) per te gjitha projektet e paraqitura, procedurat e kryera, analizen dhe rekomandimet e hartuara prej saj. Ne keto kushte, ky informacion i vihet ne dispozicion vetem KIS, i cili pas shqyrtimit te projektit dhe te analizes perfundimtare te paraqitur nga AIDA, merr një vendim, ne lidhje me pranimin apo refuzimin e kerkeses. KIS, nese konstaton se dokumentacioni eshte i paplote apo ka nevoje per informacione shtese vetem nje here, me shkrim, brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes se dosjes, plotesimin e te gjithe dokumentacionit dhe te dhenat e kerkuara, duke listuar kerkesat ne menyre specifike. Pas plotesimit te dokumentacionit nga ana e subjektit, KIS del me vendim, i cili i njoftohet subjekit.<br>Duke qene se Grupi Teknik vleresues pergatit vetem rekomandime per KIS, ne cdo rast jeni te ftuar prane zyrave tona per te konsultuar proceduren qe ndjek sekretariati teknik AIDA.<br><br>7. Cdo vendim KIS ne permbajtjen e tij ka te listuara masat mbeshtetese te miratuara dhe planet respektive te veprimit, mjafton te konsultoni ketu vendimet e publikuara tek webi i AIDA. Sqarojme se KIS pasi miraton nje mase mbeshtetese e propozon ne Keshillin e Ministrave. Pra organi qe aprovon masat mbeshtetese eshte Keshilli i Ministrave dhe akti miratues eshte VKM. Referuar pyetjeve tuaja | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ligj 55/2015 I ndryshuar dhe VKM 1030/2015 date 16.012.2015 kerkohet:<br>a. Kopje te dokumentacionit sic ka parashikuar pika 9 e VKM 1030/2015<br>b. Kopje te propozimit te KIS ku te tregohen forma, niveli dhe menyra e pjesemarrjes shteterore ne investim (pika 19 VKM 1030/2015)<br>c. Kopje te relacionit shoqerues (pika 19 VKM 1030/2015) ne te cilen trajtohen ne menyre te detajuar<br>i. interesi publik dhe jepen arsyet për të cilat konsiderohet e nevojshme pjesëmarrja shtetërore në investim;<br>ii. analiza ekonomike e investimit strategjik dhe e pjesëmarrjes shtetërore; | | me poshte do te gjeni listen me VKM te miratuara per cdo mase mbeshtetese te aprovuar ne Keshillin e Ministrave:<br>- VKM nr. 543, datë 27.07.2016.<br>- VKM nr. 544 date 27.07.2016<br>- VKM Nr. 355, datë 20.04.2018<br>- VKM nr. 70, datë 13.2.2019<br>- VKM Nr. 402, date 19.06.2019<br>- VKM Nr. 619 datë 18.09.2019<br>- VKM Nr. 1173, datë 24.12.2020<br>- VKM nr. 478, date 30.07.2021<br>- VKM Nr. 599, datë 13.10.2021<br>- VKM nr. 861, datë 29.12.2021<br>- VKM nr. 137, datë 2.3.2022<br>- VKM nr. 545, datë 29.7.2022<br>- VKM nr. 717, datë 11.11.2022<br>- VKM nr. 115, datë 01.03.2023<br>- VKM Nr. 286, datë 17.05.2023<br>- VKM nr. 433, datë 19.07.2023<br>- VKM nr. 169 datë 20.03.2024<br>Nderkohe, sa i perket masave mbeshtetese ne infrasktrukture ndihmese, me vendim te KIS subjektet qe kane perfituar masen mbeshtetese "mbeshtetje me infrastrukture ndihmese" kane perfituar vetem te drejten per te realizuar kete mase ne baze te legjislacioneve sektoriale ne fuqi. Shteti ne asnje rast nuk ka kontribuar duke mbuluar kostot per realizimin e ketyre masave.<br>8. Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) miraton masen mbeshtetese, ne fjale, vetem parimisht, ndersa miratimi perfundimtar behet me Vendim te Keshillit te Ministrave (VKM), pas permbushjes se detyrave perkatese qe (vendosen) lihen nga KIS per institucionet shteterore, mes te cilave edhe verifikimi i koordinatave respektive. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | iii. vlerësimi i avantazheve dhe rreziqeve të pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik;<br>iv. niveli i pjesëmarrjes shtetërore në raport me vlerën totale të investimit;<br>v. shkalla e ndarjes së riskut operacional midis shtetit dhe investitorit strategjik;<br>vi. ndikimet mbi tregun e lirë dhe konkurrencën që sjell pjesëmarrja e shtetit në investim;<br>vii. projekti i marrëveshjes që do të nënshkruhet ndërmjet investitorit dhe shtetit shqiptar, të përfaqësuar nga Agjencia në lidhje me kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve në realizimin e pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik. | | Ne çdo rast, sqarojme se, pavaresisht vendimeve te Keshillit te Ministrave, venia ne dispozicion e tokes shtet behet vetem pas nenshkrimit te kontrates respektive me institucionin perkates, referuar legjislacionit të fuqi. Ne kete aspekt, jo te gjitha projektet strategjike, te cilave u eshte miratuar kjo mase mbeshtetese kane VKM, apo edhe ne se kane VKM mund te kene ose jo kontrata te lidhura me institucionet perkatese shteterore. KIS me vendim ka miratuar kete mase, per te cilat eshe miratuar dhe VKM si me poshte:<br>- VKM Nr. 355, datë 20.04.2018<br>- VKM Nr. 619 datë 18.09.2019<br>- VKM nr. 70, datë 13.2.2019<br>- VKM Nr. 1173, datë 24.12.2020<br>- VKM Nr. 599, datë 13.10.2021<br>- VKM nr. 861, datë 29.12.2021<br>- VKM nr. 545, datë 29.7.2022<br>- VKM nr. 717, datë 11.11.2022<br>- VKM Nr. 286, datë 17.05.2023<br>- VKM nr. 115, datë 01.03.2023<br>- VKM nr. 433, datë 19.07.2023<br>- VKM nr. 169 datë 20.03.2024<br>9. I vetmi projekt, i cili eshte propozuar nga vete institucionet shteterore (pushteti qendror dhe lokal) e qe parashikon shpronesim eshte TEDA Tirana. Duke qene se sipas legjislacionit te investimeve strategjike, KIS miraton statusin strategjik per zhvilluesin e zones ekonomike dhe me pas procedurat vijojne sipas legjislacionit sektorial, per detaje te metejshme mund t'i drejtoheni Ministrise se Ekonomise Kultures dhe Inovacionit (MEKI).<br>10. Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) miraton masen mbeshtetese, ne fjale, vetem | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | parimisht, ndersa miratimi perfundimtar behet me Vendim te Keshillit te Ministrave, pas permbushjes se detyrave perkatese qe (vendosen) lihen nga KIS per institucionet shteterore, mes te cilave edhe verifikimi i koordinatave respektive.<br>Ne çdo rast, sqarojme se, pavaresisht vendimeve te Keshillit te Ministrave, e drejta e perdorimit te brigjeve vihet ne dispozicion vetem pas nenshkrimit te kontrates respektive, referuar legjislacionit të fuqi. Ne kete aspekt, jo te gjitha projektet strategjike, te cilave u eshte miratuar masa mbeshtetese si me siper me VKM, kane kontrate me strukturat perkatese shteterore. KIS me vendim ka miratuar kete mase, per te cilat eshe miratuar dhe VKM si me poshte vijon:<br>- VKM nr. 543, datë 27.07.2016<br>- VKM nr. 544 date 27.07.2016<br>- VKM Nr. 402, date 19.06.2019<br>- VKM nr. 478, date 30.07.2021<br>- VKM nr. 137, datë 2.3.2022<br><br>11. Duke qene se sipas VKM Nr. 1030 date 16.12.2015 ky fond menaxhohet nga MEKI, lutemi t'i drejtoheni ketij institucioni per me shume informacion.<br>Ne bashkelidhje:<br>• Nje material me pergjigjet e pyetjeve tuaja;<br>• Raportin Vjetor 2023 te AIDA;<br>• Tabelen permbledhese me projektet. | | |
| **11.** | 06.07.2024 | 1. Sa është numri i aplikimeve nga sipërmarrje me kapital tërësisht apo | 15.07.2024 | Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), është themeluar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010, "Për themelimin dhe organizimin e Agjencisë | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pjesërisht kinez që kanë aplikuar për të investuar në Shqipëri në harkun e viteve 2013-2024 të ndarë sipas viteve dhe sektorëve të ekonomisë?<br>2. Sa prej aplikimeve nga sipërmarrje me kapital tërësisht apo pjesërisht kinez që kanë aplikuar për të investuar në Shqipëri në harkun e viteve 2013-2024 të ndarë sipas viteve janë pranuar dhe refuzuar? (edhe arsyet e argumentuara të refuzimeve)<br>3. A ka një vlerësim për investimet nga Kina në Shqipëri? A janë ato të mirëpritura? | | Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve". AIDA është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.<br>Fokusi i agjencisë, në terma të investimeve të huaja, është lehtësimi dhe mbështetja e investimeve të huaja direkte në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke i ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencialë.<br>Si ndërmjetës mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë, AIDA siguron qasje në informacione të përditësuara, siguron një mënyrë efikase të komunikimit me organet qeveritare dhe shërben si një "One-Stop-Shop", duke mbështetur investitorët gjatë gjithë procesit të investimit.<br>Përgjatë periudhës 2013 – 2024, AIDA ka trajtuar disa shprehje interesi nga investitorë kinezë, por nuk janë materializuar në investime konkrete, kjo për shkak të vendimmarrjes së subjeteve të interesuara.<br>Në kuadër të ligjit nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, AIDA nuk ka trajtuar asnjë aplikim nga investitorë kinezë për marrjen e statusit "Investitor/Investim strategjik".<br>Investimet e huaja në Republikën e Shqipërisë nuk kushtëzohen nga një autorizim paraprak. Ato lejohen dhe trajtohen mbi bazën e kushteve jo më pak të favorshme se ato që iu njihen investimeve vendase në kushte të ngjashme, me përjashtim të pronësisë mbi tokën, e cila rregullohet me ligj të veçantë. Në të gjitha rastet dhe në çdo kohë investimet kanë trajtim të barabartë e të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | paanshëm, gëzojnë mbrojtje e siguri të plotë.<br>Më poshtë gjeni një tabelë me emrat e kompanive kineze të asistura nga AIDA.<br>Subjektit iu vu në dispozion tabela me investitoret dhe analiza e investimeve Kineze ne Shqiperi. | | |
| **12** | 07.08.2024 | Ne vijim te kesaj kerkese, do doja te me vendosni ne dispozicion nje informacion te updetuar per fazen ne te cilet ndodheti vleresimi i shprehjes se interesit nga ana e kompanise [redacted] per ishullin e Sazanit. Vendosni ne dispizicion projektin e propozuar nese ka ardhur nje i tille, ose sqaroni se cfare faze diskutimesh ndodheni me kompanine. | 08.08.2024 | Në vijim të kërkesës suaj ju informojmë si më poshtë vijon:<br>Për sa i takon projektit ne ishullin e Sazanit AIDA është duke vleresuar dokumentacionin dhe të gjitha kriteret ligjore që parashikon legjislacioni për investimet strategjike, përkatësisht VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit".<br>Vetë AIDA, në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA *'autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë'.*<br>Kjo dispozitë e veçantë zbërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 'Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike' ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se*:'Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar'.* | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit. | | |
| **13** | 13.08.2024 | A eshte revokuar statusi i investitorit strategjik per subjektin [redacted]<br>A eshte kerkuar pronesia e tokes per subjektin nga ana e institucionit tuaj?<br>Me ke institucione te tjerea e keni koordinuar informacionin e konsolidimit te tokes?<br>A eshte paraqitur deklarate nga subjekti investues [redacted] (a ka perfunduar projekti);<br>Cilet jane menyrat e mbeshtetjes se | 13.08.2024 | Referuar shkreses se percjelle nga Komisioneri per te drejten e informimit dhe mbrojtjen e te dhenave personale me nr.1847/1 prot., datë 7.8.2024 me objekt "Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", administruar pranë AIDA me nr.1075 prot., datë 08.08.2024, lidhur me ankesën me nr.1847 prot., datë 02.08.2024 nga [redacted], ju informojmë si më poshtë vijon:<br>Nga verifikimet e kryera pranë institucionit tonë, rezulton se në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për investimet strategjike është trajtuar projekti i investimit [redacted]<br>Në mbështetje të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | investimit te mesipme nga shteti? | | Investimeve Strategjike, lidhur me këtë projekt ka dalë me Vendimin nr.19/6 Datë 15. 07.2021. Afati i statusit investim/investitor strategjik i miratuar, ka qenë për një periudhë 3 vjeçare, afat i cili ka përfunduar më datë 15.07.2024.<br>Referuar sa më sipër, si dhe shkresës së përcjellë për trajtim nga ana juaj, sjellim në vëmendjen tuaj se subjekti nuk ka përfituar asnjë nga masat mbështetëse të miratuara në këtë vendim. Në këto kushte ky VKIS nuk është zbatuar dhe nuk ka prodhuar asnjë akt tjetër ligjor në zbatim të tij.<br>Per lehtesine tuaj gjeni bashkelidhur Vendimin e Komitetit te Investimeve Strategjike nr.19/6 Datë 15.07.2021. | | |
| **14** | 13.11.2024 | Projektin e plote dhe planin e investimit për projektin "[redacted] të miratuar me VKIS Nr.9 datë 23.07.2024 | 21.11.2024 | Në vjiim të "Kërkesë për Informacion" protokolluar pranë AIDA me Nr. 1776 Prot., datë 13.11.2024 ju informojmë si më poshtë vijon:<br>Në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA 'autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë'.<br>Kjo dispozitë e veçantë zbërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 'Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike' ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se:'Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar'.<br>Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cënuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit. | | |
| **15** | 12.12.2024 | Cilet janë investitorët, kompanitë e huaja që kanë shfaqur interes për Zonën TEDA?<br><br>Kur është afati përfundimtar i projektit TEDA?<br><br>Cilat janë planet dhe pritshmëritë për Zonën Teknologjike për Zhvillim Ekonomik nga ana juaj? | 16.12.2024 | Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është struktura administrative kompetente për dhënien e shërbimeve për investitorët të cilat aplikojnë dhe kërkojnë të përfitojnë statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë", të cilët trajtohen në zbatim të Ligjit nr.55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.<br>Ky ligj zbatohet për të gjitha investimet strategjike, që përzgjidhen si të tilla në bazë të kritereve e sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në ata sektorë ekonomikë të përcaktuar shprehimisht nga ky ligj si sektorë të investimeve strategjike.<br>Në zbatim dhe për efekt të këtij ligji, përkatësisht neni 8, janë përcaktuar edhe | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | sektorët strategjikë, ku ndër të tjera është i parashikuar edhe sektori i "Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" (TEDA).<br>Pas verifikimeve të kryera pranë institucionit tonë, rezulton vetëm një kompani [redacted] e cila është një kompani kanadeze, lider global në teknologjinë e prodhimit të metaleve e cila ka shprehur interesin e saj për të aplikuar në sektorin TEDA. Ky aplikim rezulton të jetë në fazën fillestare të shprehjes së interesit.<br><br>Lidhur me pyetje tuaj të dytë, përsa i përket afateve të projektit TEDA, ju informojmë se subjektet aplikuese në zbatim të VKM nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", dorëzojnë setin e plotë të dokumentacionit, ku ndër të tjera përcjellin programin e punës me afatet e punimeve që do të kryhen në zbatim të projektit të propozuar. Ky afat mund të jetë i ndryshëm në secilin nga projektet.<br><br>Lidhur me pyetjen tuaj të tretë përsa i përket planeve dhe pritshmërive për zonat teknologjike për zhvillim ekonomik, sqarojmë se planet e përgjithshme afatmesme dhe afatgjata hartohen nga organet qëndrore politik-bërëse dhe në rastin konkret ministria përgjegjëse për ekonominë, ndërkohë që AIDA është institucion ekzekutiv/zbatues i këtyre politikave. Për më shumë informacion mund t'i drejtoheni minstrise përgjegjëse për ekonominë. | | |
| **16** | 16.12.2024 | Në dobi të procesit të punës si media, kërkojmë vënien në | | Kërkuesit ju vu në dispozicion tabela me listën e projekteve të miratuara në kuadër të legjislacionit të Investimeve Strategjike. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dispozicion të një liste të të gjitha projekteve të miratuara në kuadër të ligjit për investimet strategjike 2016-2024 përfshirë emrat e përfituesve, vlerën e projekteve dhe destinacionin e zhvillimit. | | | | |